

VENDIM
Nr. 404, datë 4.7.2018

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME, TË NJË PJESE TË
PRONËS ME NUMËR RENDOR 180, ME EMËRTIMIN “POLICIA USHTARAKE
(REPARTI USHTARAK NR. 6620)”, ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për një periudhë 20-vjeçare, të një pjese të pronës me numër rendor 180, me emërtimin “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)”, me sipërfaqe të përgjithshme 31 641,4 m², me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale.

2. Ministrisë së Brendshme i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pjesës së pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet të kryejë ndryshime infrastrukturore në objektet e dhëna në përdorim ose ndërtime të reja infrastrukturore pa miratimin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme të nënshkruajnë aktmarrëveshjen përkatëse për dhënie në përdorim të pjesës së pronës me numër rendor 180, me emërtimin “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)”, sipas pikës 1, të vendimit, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella për secilin institucion.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PRONA Nr.180 (Policia Ushtarake Sauk Tirane.)

**MIRATO HET
KOMANDANTI I POLICISE USHTARAKE
KOLONEL EKLAND DASHI**

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 1605,3266.
Nr.Pasurise _____ Vol. _____ Fq. _____
Indeksi i Hartes
K-34 100-(27-B),K-34-100-(28-A).
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise Tiranë
Q/F Sauk,Tiranë.
Pronari:
Ministria e Mbrojtjes,Policia Ushtrisë


PUNOI

Ing. Ernal MACÊ

SHPIEGUESE

Sip.e Prones nr.180 matur n.e dijektor 2017
sipas gjendjes aktuale te rrethimit = 31641,4 m²

Slip.něn objekt=4048,25 m²



Shënim:
Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Policisë Ushtrake nr.6040/1, datë 13.12.2017. Bazuar në matjet e bëra mes Dastë 13.12.2017 ne kufijt faktik të prondës të regjuar nga përfaqëuesi i Policisë Ushtrake

Time 14/12/2017